

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA OF KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 16936/25  
Nr. / fq. / Br. et. - 7 -  
Data / Datum: 18.04.25

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vuçitrn -- Municipality of Vushtrri



### Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 68/25 18/04/2025

### PROCESVERBAL

nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17 mars 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Agron Perçuku, Adnan Labu, Fakete Dushi, Sylejman Mehollli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi, kryetar i komunës, Hava Mlinaku, nënkryetare e komunës, drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na kanë ardhur edhe tri pikë shtesë për t'i shtuar në rend të ditës:

- Kërkesë për mbështetje financiare për Endrit Latifin;
- Propozim-vendim për shfuqizim të vendimit të kuvendit të komunës;
- Propozim-vendim për përkrahje financiare për Shkodran Imeraj.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – propozoi që pika 7 - “Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për Dëshmorin, Avni Saraçi”, të hiqet nga rendi i ditës. Ai tha se rruga mban emrin e dëshmorit, Avni Saraçi, por nuk kemi lënë vend për ndërtimin e bustit, për shkak të një invazioni nga kërkesat e shumta. Kjo është e veçantë, sepse dëshmori ka rënë në atë vend. Por, për t'u ndërtuar busti duhet pëlqim edhe prej bizneseve që i kemi dhënë në shfrytëzim. Deri në këtë moment nuk ka ardhur pëlqimi, kur të na vjen pëlqimi ne do ta procedojmë. Lidhur me “Propozim-vendimin për shfuqizim të vendimit të kuvendit të komunës”, parcela gjendet në hapësirën që gjendet QKMF-ja, ku 20 ari kanë qenë të dedikuara për banim social. Ai tha se për banim social e kemi dërguar parcelën në ministri, ku gjendet shtëpia e pleqve. Pra, qëllimi është që këta 20 ari t'i ipen në shfrytëzim QKMF-së për ta shfrytëzuar si parking.

**Sylejman Mehollli, anëtar i KPF-së** – pyeti se sa ari në përgjithësi janë dhënë në shfrytëzim në këtë parcelë në vitin 2006 për rastet sociale? A është e përfshirë tërë sipërfaqja, apo vetëm një pjesë e saj? Ndërkaq, lidhur me parcelën të shtëpia e pleqve, ka pasur dilema sa i përket pronësisë. Kush është pronar i asaj parcele? Mendoj se nëse ligjërisht jemi në rregull, është ide e mirë që të ketë aty banesa sociale, sepse është vend i përshtatshëm dhe është afër QKMF-ja, Shtëpia e Pleqve, shkolla.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** tha se 20 ari janë të dedikuara për banim social. Kurse, pjesa tjetër është e dedikuar për kategoritë tjera, për familje të dëshmorëve dhe invalidë të luftës. Lidhur me parcelën të shtëpia e pleqve, ju kemi treguar ministrisë që prona është e AKP-së. Ata e kanë pranuar si të tillë dhe janë zhvilluar procedurat për një gjë të tillë.

**Adnan Lahu, anëtar i KPF-së** – lidhur me pikën 7, pajtohem plotësisht. Për këto tema të ndjeshme duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Përpos që e kemi dhënë në shfrytëzim atë parcelë, ai vend është edhe zonë e mbrojtur (Ura e Gurit) dhe është dashur të merret pëlqim edhe nga Instituti për Trashëgimi Kulturorë. Nëse merren pëlqimet është në rregull, nëse jo të shikohet mundësia që të gjendet ndonjë lokacion aty afër.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – pajtohem që të bëhet shfuqizimi i vendimit të vitit 2006 dhe t'i ipet QKMF-së. Por, të figurojë brenda vendimit destinimi për QKMF, që në të ardhmen mos t'i ndryshohet destinimi.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – pajtohem edhe unë që të jetë pjesë e vendimit destinimi për nevojat e QKMF-së.

**Mentor Hasani, anëtar i KPF-së** – lidhur me këtë shfuqizim të vendimit, në mënyrë që t'i ipet QKMF-së në shfrytëzim. Bëhet fjalë për zgjerim të parkingut të Qendrës së Mjekësisë Familjare. Drejtorja ka kaluar aty, edhe laboratorit së shpejti do të transferohet. Në laborator zakonisht ka 70-100 pacientë në ditë, ku janë së paku 60-70 vetura. E falënderojmë kryetarin dhe drejtorin që kemi gjetur gjuhë të përbashkët për iniciimin e kësaj çështjeje dhe shpresojmë që të realizohet sa më shpejtë që të jetë e mundur.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – edhe unë pajtohem që ka nevojë të zgjerohet hapësira për parking aty, por shpresojmë që nuk iu është prekur lokacioni kategorive tjera. Lidhur me bustin, edhe unë po pajtohem që këto janë tema të ndjeshme dhe duhet të trajtohen me kujdes. Pata propozuar vitin e kaluar, që ta bëjmë një rregull dhe çdo vit të ndërtojmë disa buste, lapidarë, deri të përfundohet në tërësi.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri vendosi që të shtohen në rend të ditës pikat shtesë.**

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri vendosi që të hiqet pika 7 nga rendi i ditës.**

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

## R E N D I T E

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14.02.2025
2. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2024
3. Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025
4. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025
5. Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024
6. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2024

7. Propozim – vendim për ndryshim dhe plotësimin e vendimit për rritje të vlerës për shërbime të varrimit
8. Kërkesë për mbështetje financiare për Endrit Latifin
9. Propozim-vendim për shfuqizim të vendimit të kuvendit të komunës
10. Propozim-vendim për përkrahje financiare për Shkodran Imcraj
11. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14.02.2025.

**Fakete Dushi, anëtare e KPF-së** – kërkoi që të përmirësohet një gabim teknik, ku unë kam propozuar që një rrugë ta ketë emrin “Haxhi Beshiri”, e jo “Haxhi Beqiri”.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 14.02.2025.**

2. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2024.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – lidhur me këtë çështje, ai tha se ka marrë ankesa nga banorët e Dumnicave (që më kanë dërguar foto), lidhur me kualitetin e rrugës, të cilët janë të pakënaqur me trashësinë e shtresës së asfaltit. Po ashtu, banorët janë ankuar në njërin Dumnicë janë vendosur shumë pengesa në rrugë (policë të shtrirë), kurse në tjetrën s’ka fare.

Një shqetësim tjetër është tek lagjja “Gërxhaliu” në Studime, ku është e vetmja lagje që nuk është përfshirë në ndriçim.

Pastaj, rrugët që po punohen (si rasti i rrugës nga lumi “Silnica” deri te fabrika “Llamkos”), nëse ka mundësi t’i thoni punëkryesit që nëse nuk është gati për asfalt, mos të gërryhet rruga, sepse po krijon kolona të mëdha të automjeteve, si dhe po dëmtohen veturat.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – sa i përket cilësisë së asfaltit në Dumnicë, po ju sigurojë se do të punohet sipas projektit, sepse mbikëqyret nga menaxheri i projektit, por edhe nga kompania.

Lidhur me pengesat (policët e shtrirë), nuk është e preferueshme që të vendosen shumë pengesa.

Sa i përket ndriçimit në lagjën “Gërxhaliu”, nuk është e vetmja që ka mbetur. Vitin e kaluar i kemi mbetur borxh kompanisë “Përparimi”, për shkak të mjeteve që na i ka marrë përmbaruesi lidhur me obligimet që janë dalë nga Kontrata Kolektive.

Lidhur me rrugën nga lumi “Silnica” deri te fabrika “Llamkos”, besoj që shumë shpejt do të fillojë asfaltimi i saj.

**Fatmirë Cecelia, anëtare e KPF-së** – pyeti se çka do të bëhet me lumin “Tërstena”? ajo tha se deri më tani vetëm është gërryer dhe ka mbetur me rërë dhe nuk është përfunduar asgjë. Janë dëmtuar rrethojat e metalta që e rrethojnë lumin.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se është mirë që te rrethi në dalje të Vushtrrisë të vendosen pengesa, për arsye se banorët po rrezikohen gjatë daljes nga rrethi në rrugën “Qemajl Shaqiri”, sepse veturat po vijnë me shpejtësi të madhe dhe nuk po e shikojnë anën e djathtë. Po ashtu, të vendosen pengesa afër rrethit nga pjesa ku veturat vijnë nga Prishtina, sepse hyjnë në rreth me shpejtësi të madhe. Si pasojë e kësaj, po ka aksidente të shpeshta aty.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – kam ankesa të shumta nga banorët e fshatit Balinc, Liqej, pjesa e epërme e Shtitaricës, pjesa e epërme e Akrashticës, pjesa e epërme e Taraxhës, ku në javën e fundit ka pasur reduktime të shumta të ujit. E di që furnizimi me ujë bëhet nga KRU “Ujësjiellësi”, por si komunë duhet të rritet presioni ndaj kompanisë. Është e padrejtë që fshati që e ka në pronën e vet fabrikën e ujit e mos të ketë ujë. Kurse, disa pjesë tjera të qytetit të kenë ujë, është shumë e padrejtë.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – pajtohem plotësisht me rrezikun që po paraqitet të rrethi në dalje të qytetit. Shoferët duhet të jenë të vetëdijësuar dhe të vozisin me kujdes, sepse ekzistojnë vendkalimet për këmbësorë.

Lidhur me lumin “Tërstena”, ai tha se të muzeu, në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim kemi ardhur në përfundim me i heq pengesat (që kanë qenë si shëtitore), për shkak se kur kanë qenë vërshimet e mëdha, pikërisht në atë vend u atakojke uji, po ashtu edhe ura është pak e ulët. Shtrati i lumit ka mbetur i pa betonuar dhe se do të betonohet më vonë. E njëjta pengesë është edhe të parku i qytetit.

Pajtohem me mungesën e furnizimit me ujë në pjesët e epërme të fshatrave që i ceku Sylejmani. Ka pasur reduktime edhe të fshatrat Novolan, Vërnice, Mihaliq. Këto shqetësime i kam adresuar të kryeshefi ekzekutiv i KRU “Ujësjiellësi”. Në atë kohë, kompania e kishte reduktuar prodhimin e ujit, për shkak të humbjeve në rrjet.

Lajmi i mirë për qytetarët e komunës së Vushtrrisë dhe Mitrovicës është ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, ku e kemi nënshkruar marrëveshjen me BERZH-in dhe ministrinë përkatëse.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

3. Bartja e të hyrave vjetanake nga viti 2024 në vitin 2025.

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

4. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025.

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

5. Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024.

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

6. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2024.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – komplimente për drejtoreshën, e cila i ka dhënë një imazh krejt ndryshe komunës.

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

7. Propozim – vendim për ndryshim dhe plotësimin e vendimit për rritje të vlerës për shërbime të varrimit.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – deklaroi se viteve të fundit shumë shpesh ua kemi rritur subvencionimin e shërbimeve të varrimit, e cila nuk ka qenë praktikë e mëhershme. Ajo që është e rëndësishme për qytetarët, e kanë hequr nga shërbimi hapjen e varrit. Prandaj, 200 euro për procedura të varrimit, pa hapjen e varrit, mendoj që kërkon auditim. Kurse, tani kërkojnë edhe më tutje rritjen e vlerës financiare në 270 euro. Çka është shtrenjtuar? Nuk ka bazë që ta votojmë, sepse nuk ka arsytim të qëndrueshëm. Unë do të abstenojë. Nëse deri në seancën e kuvendit na sjellin arsyetimet e duhura, nuk do të bëjmë pengesë për të hyrë në kuvend.

**Adnan Lahu, anëtar i KPF-së** – theksoi se në material e kemi edhe vendimin e vitit 2022, kur është rritur vlera nga 180 në 200 euro. Kurse, tani është propozuar një shumë e madhe e rritjes së vlerës financiare në 270, e cila do një analizë. Nëse nuk ka sqarime, do të abstenojë edhe unë.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – është mirë të ceket deri në seancë se cilat shërbime përfshihen në këtë. A përfshihet hapja e varrit? A do të bëhet hapja e varrit vetëm në qytet, apo edhe në fshatra?

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – edhe herën e fundit kur është rritur shuma financiare, kam qenë skeptike. Çdo dy vite të rritet vlera financiare, po më duket e paarsyeshme. Nëse përfshihet edhe hapja e varrit, unë do ta mbështes. Përndryshe, në këtë formë kështu, nuk mund ta përkrahu. Çdo vit Bashkësia Islame e merr anëtarësinë nga qytetarët, po ashtu subvencionohet edhe nga komuna, pse mos ta bëjnë edhe hapjen e varrit. Në memorandumimin fillestar ka qenë e përfshirë hapja e varrit. Kurse, shërbimi i hapjes së varrit është hequr pa na njoftuar neve si kuvend.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – nuk duhet të lejojmë diskriminimin fshat-qytet. Nëse bëhet hapja e varrit duhet të bëhet për të gjithë qytetarët.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – nëse ka vendim që hapja e varrit të bëhet vetëm në qytet është diskriminues dhe duhet të kthehet në kuvend për shfuqizim. Sa i përket kërkesës për rritjen e vlerës financiare nga 200 në 270 euro, deri në mbledhjen e kuvendit do të kërkojmë sqarime nga Bashkësia Islame. Po ashtu, nëse jeni dakord së bashku me shërbimet e grupeve kuvendare shkojmë dhe bisedojmë me Bashkësinë Islame.

**Adnan Lahu, anëtar i KPF-së** – do ta procedojmë në kuvend, por nëse nuk vijnë materiale shtesë, atëherë do ta heqim nga rendi i ditës në kuvend. Po ashtu, edhe drejtorja gjegjëse u kanë mirë të shikojë në komunat tjera se sa është pagesa e shërbimeve.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tetë (8) vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

8. Kërkesë për mbështetje financiare për Endrit Latifin.  
*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

9. Propozim-vendim për shfuqizim të vendimit të kuvendit të komunës.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – tha se në titull të vendimit le të vendoset “Propozim-vendim për shfuqizim të vendimit të kuvendit të komunës me dedikim për zgjerimin e infrastrukturës së QKMF-së”.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

10. Propozim-vendim për përkrahje financiare për Shkodran Imeraj.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – para se të ndahen subvencione të reja, duhet ta dimë se a kanë përfunduar pagesat e subvencioneve të mëhershme. Një vendim që është votuar më herët për artisten Belinda Mehana, sa kam informacione ende nuk i janë ekzekutuar mjetet financiare. Po ashtu, nuk kemi informacione se çka ka ndodhur me vendimin për ndarjen e pakos ushqimore për festën e Bajramit. Njëjtë ka ndodhur edhe me shujtat e zyrtarëve të administratës. Të gjitha këto kanë prodhuar një lloj mashtrimi.

Meqenëse ky propozim-vendim ka të bëjë me një libër për masakrën e Studimes, ne e mbështesim, sepse duhet të mbesin dokumente të shkruara, ku është njëra prej masakrave më të mëdha.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – nuk pajtohem që t’iu ndajmë mjete financiare njerëzve jashtë komunës sonë. Kemi mjaft historian dhe doktor shkence edhe nga komuna jonë. Është edhe Izeti doktor shkence që mund ta bëjë një libër të tillë. Para disa seancave është marrë një vendim për mbështetjen e një libri për Mentor Hasanin. A i janë ndarë mjetet financiare? Deri ku ka shkuar shkrimi i këtij libri, a është kryer pjesa e parë?

Ky propozim-vendim nuk është urgjent. Andaj, kisha propozuar që të aplikojë kur është koha e subvencioneve, ku është fondi për botimin e librave.

**Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – deklaroi se nuk është iniciativë e jona që ta angazhojmë këtë autor për botimin e librit për masakrën e Studimes. Është iniciativë e tij dhe e Institutit të Historisë. Ai ka bërë kërkesë për përkrahje financiare. Përveç masakrës së 2 Majit në Studime, do të përfshihet edhe masakra ndaj tetë vajzave, si dhe masakra e 31 Majit. Lidhur me vendimin për Mentor Hasanin, ky vendim ka hyrë në fuqi, pasi nuk ka vlerësim të ligjshmërisë brenda afatit ligjor. Ne planifikojmë që ta zbatojmë këtë vendim në muajin maj, ku e kemi në plan të prokurimit.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – kur po propozojmë për dikë nga Vushtrria, po bëhet shumë e madhe. Një propozim e kam bërë për botimin e një libri kushtuar luftës së Batalionit të parë të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës të UÇK-së, autorit mezi i janë ndarë ato mjete financiare. Kurse, dikujt që e bën një libër për kohën e osmanëve me ju nda 9000 euro, kjo është padrejtësia që po bëhet me këto përkrahje financiare.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – më herët e diskutuam se po shkelet rregullorja, sepse propozimet që vijnë nga qeveria komunale (kanë edhe arsyeshmëri financiare për mjetet ku do të merren), e nuk vijnë prej një anëtari të kuvendit nëse nuk është urgjente. Kurse, propozimi yt ka qenë në seancë (aty për aty) dhe për këtë arsye nuk ka gjet përkrahje, sepse duhet të shikohet se ku ka mjete financiare. E kemi përkrahur botimin e librit për kohën osmane, sepse pa u hapur arkivat në qendrat kryesore në: Stamboll, Romë, Vjenë, Berlin dhe Londër, nuk do të mësohet e vërteta e historisë sonë. Prandaj, studiuesja turke me

origjinë shqiptare bashkë me studiuesit tanë më së shumti kanë gjetur dokumente për Vushtrinë. Edhe komuna e Gjakovës dhe Ferizajt e kanë sponsoruar një libër të tillë. Ai tha se janë mbi 2000 dokumente që do të zbardhen për Vushtrinë dhe do ta shohim vlerën e tyre.

Sa i përket librit për masakrën e Studimes, Shkodrani është një studiues i shkëlqyeshëm, i cili punon në Institutin e Historisë. Mos ta injorojmë askënd, sepse tjetër është një studim shkencor nga njerëzit adekuat, e tjetër është një monografi. Ky libër është në përfundim e sipër, andaj kërkoj që ta mbështetni, sepse u jep krejt tjetër ngjyrë këtyre ngjarjeve.

Sa u përket vendimeve për përkrahje financiare që kanë mbetur pa u ekzekutuar, është për shkak të mungesës së mjeteve financiare, për shkak të bllokimit të buxhetit nga përmbartuesi lidhur me të drejtat që kanë dal nga Kontrata Kolektive. Ai tha se vendimin për Belinda Mehanën e ka nënshkruar.

Sa i përket vendimit për shujta dhe pakos për zyrtarë të administratës, kurrë mos me pa pushtet, nuk kqyri me mashtruar dikë. Por, nëse ka qenë gabim, atëherë gabimi është bërë nga zyrtarët ligjor, jo nga unë, sepse paraprakisht më kanë siguruar që këto vendime do të ekzekutohen.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – nuk jam kundër përkrahjes së botimit të këtyre librave, por mënyra se si po ndahen subvencionet nuk po më pëlqen. Prandaj, të bëhet ndarja me thirrje publike.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – i kam propozuar drejtorisë ta draftojë rregulloren për ndarjen e subvencioneve, ku rregullorja aktuale ka mangësi, sepse kur shpallet thirrja publike bëhet vetëm për persona juridik. Andaj, ta ndryshojmë rregulloren dhe t'u ipet mundësia edhe personave fizik. Rregullorja aktuale nuk e mundëson ndarjen e mjeteve financiare përmes thirrjes publike për persona fizik.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – kjo është kërkesë direkte nga Instituti i Historisë, i cili e ka përzgjedhur Shkodranin që ta shkruajë këtë libër.

Çka do të bëhet tash e tutje me vendimin për shujtat e zyrtarëve të administratës? Pse s'po publikohet në faqe të komunës, pasi që zyrtarët kanë angazhuar edhe një avokat. Mendoj se do ta humbni si rast edhe këtë në gjykatë, sepse vendimi nuk është shfuqizuar.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – vendimet e jashtëligjshme nuk publikohen në faqen e komunës, kjo është arsyeja pse nuk e kemi publikuar.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

11. Pyetje dhe përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën **11:20**.

**Bujar Klinaku**



**Procesmbajtës**



**Kryesuese e KK-së dhe KPF-së**